

SHTOJCË NR. 1, DATË 17.06.2020

“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, Tender i Hapur mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të Marrëveshjes Kuadër 24 muaj me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura”, i ndarë në 21(njëzetë e një) Lote , me fond të përgjithshëm 906,697,983 (nëntëqind e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, me REF-58409-05-18-2020.

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 904prot., datë 04.06.2020 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në organin qendror blerës ABP, bëhen ndryshime në dokumentat e **tenderit në të gjitha Lotet** pra tek Loti 1; Loti 2; Loti 3; Loti 4, Loti 5, Loti 6, Loti 7, Loti 8, Loti 9, Loti 10, Loti 11, Loti 12, Loti 13, Loti 14, Loti 15, Loti 16, Loti 17, Loti 18, Loti 19, Loti 20 dhe Loti 21 si vijon:

Tek Shtojca 9 “Specifikimet teknike për të gjitha lotet (Loti 1 deri tek loti 21)” tek seksioni “Programi Ushqimor” tek rubrika “Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit” **specifikimi teknik:** “Kontraktuesi merr përsipër gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit për efektivat ushtarakë gjatë stërvitjeve jashtë vend dislokimeve të reparteve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”

NDRYSHON DHE BËHET: “Kontraktuesi mundëson ushqimin për efektivat ushtarakë gjatë stërvitjes jashtë Repartit deri në vend dislokimin e përkohshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Tek Shtojca 12 “**TERMAT E REFERENCËS**” tek rubrika “Detyrat” **përcaktimi:** “Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit në rast dalje të efektivit jashtë vendvendndosjes së përhershme të repartit në detyra e stërvitje të ndryshme brenda teritorit të RSH.”

NDRYSHON DHE BËHET: “Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit në rast dalje te efektivit jashtë vendvendndosjes se përhershme të repartit në detyra e stërvitje të ndryshme deri në vend dislokimin e përkohshem brenda teritorit të RSH.”

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, për të gjitha Lotet (Loti 1 deri Loti 21) , shtyhet për në datën 17.07.2020 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.